



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.143

8 tetor

2009

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Akt normativ nr.4, datë 24.9.2009	Për dërgimin e një toge mjekësore, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Kabul, Afganistan 6483
Akt normativ nr.5, datë 30.9.2009	Për një ndryshim në ligjin nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar 6485
Akt normativ nr.6, datë 30.9.2009	Për një ndryshim në ligjin nr.8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, të ndryshuar 6485
Akt normativ nr.7, datë 30.9.2009	Për një ndryshim në ligjin nr.10 130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit” 6486
Akt normativ nr.8, datë 30.9.2009	Për një ndryshim në ligjin nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik” 6486
Dekret nr.6268 datë 25.9.2009	Për lënie të shtetësisë shqiptare 6487
Dekret nr.6269 datë 2.10.2009	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar në njësinë bashkiake nr.10, Tiranë 6487
Dekret nr.6270 datë 2.10.2009	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar bashkie në bashkinë Klos 6488
Dekret nr.6271 datë 2.10.2009	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar bashkie në bashkinë Fushë-Arrëz 6488
Dekret nr.6272 datë 2.10.2009	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar komune në komunën Fierzë 6489

Dekret nr.6273 datë 2.10.2009	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar komune në komunën Otlak	6489
Dekret nr.6274 datë 5.10.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	6490
Vendim i KM nr.943, datë 26.8.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Helmës të qarkut të Tiranës	6490
Vendim i KM nr.944, datë 26.8.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Papër të qarkut të Elbasanit	6491
Vendim i KM nr.945, datë 26.8.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pishaj të qarkut të Elbasanit	6492
Vendim i KM nr.946, datë 2.9.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Krumë të qarkut të Kukësit	6494
Vendim i KM nr.947, datë 2.9.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kolonjë të qarkut të Fierit	6495
Vendim i KM nr.948, datë 2.9.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Gradisht të qarkut të Fierit	6496
Vendim i KM nr.949, datë 2.9.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dajt të qarkut të Tiranës	6497
Udhëzim i METE nr.317/1, datë 4.9.2009	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”.....	6498
Udhëzim i MD nr.7203, datë 16.9.2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”.....	6501
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Namik Danglli	6502
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Klement Metushi	6502
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sali Tabaku ...	6503
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Xhevair Gezdari....	6503
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Bajram Maci....	6503

AKT NORMATIV
Nr.4, datë 24.9.2009

**PËR DËRGIMIN E NJË TOGE MJEKËSORE, TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË KABUL, AFGANISTAN**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes,
Këshilli i Ministrave

VENDOSI:
Neni 1

Dërgimin e një toge mjekësore, prej 20 (njëzet) vetash, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, në Kabul, Afganistan.

Neni 2

Misioni i autorizuar i togës mjekësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë mbështetja mjekësore, në operacionin ISAF të forcave pjesëmarrëse, nën komandën e zonës së Kabulit, përgjegjësi e palës turke.

Neni 3

Toga mjekësore do të veprojë në përbërje të njësisë speciale shëndetësore të Kamp Dogan Rol-2 dhe do të kryejë këto detyra:

a) Mbështetje mjekësore të forcave pjesëmarrëse në operacion, nën komandën turke, në Kabul, Afganistan.

b) Mbështetje mjekësore të strukturave të bashkëpunimit civilo-ushtarak (CIMIC), që do të dalin në terren në ndihmë të popullsisë civile, vendore, për skanimin shëndetësor të zonës, brenda rajonit të Kabulit.

Neni 4

Kohëzgjatja e misionit të togës mjekësore do të jetë 1 (një) vit.

Neni 5

Ushtarakët, që do të marrin pjesë në këtë mision, për çdo ditë qëndrimi, veç pagës mujore, do të marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, të njëjtë me atë të ushtarakëve, që dërgohen në mision, në përputhje me ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”, të ndryshuar.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Efektet financiare të togës mjekësore që do të shërbejë në ISAF 2009-2010

000/lekë

KABUL	Nr. Pers.	Paga ditore(\$)	Paga vjetore	Kursi	Kosto për 3 muaj	Kosto vjetore
Shpërblimi ditor	20	60	432,000	100	10,800	43,200
Sigurimi i jetës në (lekë)	20	0,563	4,054		1,013	4,054
Shuma						47,254
Shpenzime të tjera						
Materiale shëndetësore (vaksina, barna, materiale mjekimi dhe pajisje)	20	0,097			175	698
Transport strategjik të sëmurësh	3-4 vetë				2,200	8,600
TOTALI					2,375	56,552

AKT NORMATIV
Nr.5, datë 30.9.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9948, DATË 7.7.2008 “PËR SHQYRTIMIN E
VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN
BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Fjala e parë, e nenit 5 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në zbatim të këtij ligji, krijohet, si strukturë e veçantë, Komisioni Qeveritar i Tokës (KQT).”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AKT NORMATIV
Nr.6, datë 30.9.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8669, DATË 26.10.2000 “PËR REGJISTRIMIN E
PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË DHE TË BANESAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Fjala e parë, e nenit 11 të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AKT NORMATIV
Nr.7, datë 30.9.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.10 130, DATË 11.5.2009 “PËR FONDIN SHQIPTAR
TË ZHVILLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Nënndarja “i” e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.10130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i) Kryetari i këshillit drejtues të FSHZH-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AKT NORMATIV
Nr.8, datë 30.9.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9880, DATË 25.2.2008 “PËR NËNSHKRIMIN
ELEKTRONIK”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në pikën 2 të nenit 10 të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, fjalët “...të ministrit, që mbulon punët e brendshme” zëvendësohen me “...të ministrit përgjegjës të fushës, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DEKRET
Nr.6268, datë 25.9.2009

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohej lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tij:

Fisnik Ibrahim Haçkaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6269, datë 2.10.2009

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR NË NJËSINË BASHKIAKE
NR.10, TIRANË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për kryetar për njësinë bashkiake nr.10, Tiranë, zhvillohen ditën e diel, datë 15 nëntor 2009.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6270, datë 2.10.2009

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË KLOS

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për kryetar bashkie në bashkinë Klos, zhvillohen ditën e diel, datë 15 nëntor 2009.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6271, datë 2.10.2009

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për kryetar bashkie në bashkinë Fushë-Arrëz, zhvillohen ditën e diel, datë 15 nëntor 2009.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6272, datë 2.10.2009

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE NË KOMUNËN FIERZË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për kryetar komune në komunën Fierzë, zhvillohen ditën e diel, datë 15 nëntor 2009.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6273, datë 2.10.2009

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE NË KOMUNËN OTLLAK

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për kryetar komune në komunën Otllak, zhvillohen ditën e diel, datë 15 nëntor 2009.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6274, datë 5.10.2009

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7, dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre pesonave të mëposhtëm:

1. James Adam Belushi
2. Fetah Ismajl Podvoriva

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.943, datë 26.8.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS HELMËS TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Helmës, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Helmës të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.877, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Helmës, të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Helmës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
13-16	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
18-32	Varreza publike	Në pronësi
321-658	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
95-99,117,123,124,126-128,135,145-148,152-155,158,162	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
33-41	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
46-78,80,81,84-94,100-116,118,122,125,129-134,136-144,149-151,156,157,159-161,163-177.	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
178,179,181-184,186-189,191-194,196-199,201,202,204-206,208-210,212-215,217-219	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
180,185,190,200,203,207,211,216,220,223,224,226,227,229,233,236,239,242,245,247,250-252	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në përdorim
690-702	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM**Nr.944, datë 26.8.2009**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS PAPËR TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Papër të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Papër të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.728, datë 7.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Papër, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Papër për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Papër

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
15-17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
18-24	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
25-45	Varrezat publike	Në pronësi
46-58	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në mbrojtjen civile.	Në pronësi
63-69,128-130,136-137,139-140,143-145,148-151,288-292,338-341,390-396	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
342-344,348-350,352-354,357-359,361-367,369-375,378-380,384,386-388,191	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
346,347,351,356,360,368,376,377,382,383,385,389,345,355,381,545,549,552,558,561,562-656 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
670-744,745-783,786-829,832-1022,1024-1057	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM
Nr.945, datë 26.8.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS PISHAJ TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pishaj, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Pishaj të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.1645, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Pishaj, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Pishaj për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pishaj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
10-33	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
34,36-40	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
42-45	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
46,47,50	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
51-59,62-70	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
79-111	Varrezat publike	Në pronësi
246-270,273-303,305-376,378-382,384-396,399-404,406-407,409	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
410-422,424-440,442,443,445-474,478,480-500,502-514,516-519	Infrastrukturë (rrugë vendore).	Në pronësi
564,565,569-571,575-577,582-584,588-591,594-597,601,605-607,611-613,617-619,623-626,631,635,641-649,653-659	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
566-568,572-574,578-581,585-587,592-593,598-600,602-604,608-610,614-616,620-622,627-630,632-634,636-640,650-652,660-662,663-762 (vetëm kanalet e III)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1088	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.946, datë 2.9.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË KRUMË TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Krumë të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 72 fletë (shtatëdhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi përfundon me numrin rendor 383 (treqind e tetëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Krumë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Krumë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4,5,17,18,19,21,24-28	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
35-48	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
49-52,54,256-289,294-302, 303-324	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës.	Në pronësi
55,57,58,59,60-62	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
56,63,64/8,65/3,66/2	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
185-203	Shërbim funeral	Në pronësi
204-222	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi
248,252-255	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
325-339	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore e sportive.	Në pronësi
362-363	Prona që përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm.	Në pronësi
365	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi

364	Troje të lira	Në përdorim
340-358,364	Infrastrukturë vendore, sheshe, lulishte, trotuare (në pronën 364 nuk transferohen trojet e lira).	Në pronësi

VENDIM
Nr.947, datë 2.9.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KOLONJË TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kolonjë të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 318 (treqind e tetëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kolonjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kolonjë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
98-106	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore e sportive.	Në pronësi
112-117	Shërbim funeral	Në pronësi
171-179,184-192,194,195,308, 315	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe, trotuare dhe shërbime publike)	Në pronësi
118-168,303-307,309-314,316-318	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna midis ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
202-209	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
302	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi

14-26	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
40-97	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
180-183	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
27-39,219,244,251,261,266,276,279,287,291	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi

VENDIM
Nr.948, datë 2.9.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GRADISHT TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gradisht të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 51 (pesëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 290 (dyqind e nëntëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gradisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
13-16	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
17-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore e sportive.	Në pronësi
22-38	Shërbim funeral	Në pronësi
39	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, trotuare)	Në pronësi
9-23,185,186	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje)	Në përdorim
52,53,60,62-64,287	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
68-98	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
129-141,176-184	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, trotuare)	Në pronësi
187-195,286	Furnizim me ujë të pijshëm	Në pronësi
143,145,147,149,151,153,154,158,159,160,163,167,168,169-175,215,220,235,242,247,261,271,275,288,289	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
142,144,146,148,150,152,155,156,157,161,162,164,165,166	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

VENDIM
Nr.949, datë 2.9.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DAJT TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dajt të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Dajt të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.1490, datë 12.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dajt, të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Dajt për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
6497

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
16	Prona që përdoren për shërbime sociale.	Në pronësi
17-33	Varreza publike	Në pronësi
34-51	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
101-240	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
245-255	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
733	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
734	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive).	Në përdorim

UDHËZIM**Nr.317/1, datë 4.9.2009****PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1719, DATË 17.12.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr.7926, datë 20.45.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

1. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, procedurat bëhen në përputhje me seksionin V, “Likuidimi” të kreut VI “Dispozita të përbashkëta për të gjitha format e shoqërive”, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Operacionet e likuidimit kryhen nga likuidatori, i cili përfaqëson shoqërinë dhe ka për objekt mbylljen e llogarive dhe çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Me kalimin e shoqërisë në likuidim hartohet bilanci i likuidimit, i cili verifikohet dhe vërtetohet nga eksperti kontabël i autorizuar. Bilanci, për efekt likuidimi, miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shërben si pikënisje për identifikimin e aseteve, elemente të pasurisë, që do të likuidohet.

4. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, shiten nëpërmjet ankandit publik, pas publikimit në Buletin e Njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Njoftimi për shitje bëhet katër herë radhazi, nga data e dërgimit të njoftimit për shitje, si dhe afishohet edhe në mjediset e shoqërisë e në objektin që do të shitet. Njoftimi në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet dhe ndiqet nga autoriteti shitës, i cili bën dhe dorëzimin e dokumenteve standarde të ankandit të shpallur kandidatëve blerës kundrejt një pagese të përcaktuar në njoftimin për ankand.

5. Ankandet për shitjen e pasurive të ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare shtetërore në likuidim bëhen në mjediset e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Njësia e ankandit përbëhet nga jo më pak se 3 veta, të cilët përcaktohen me urdhër të likuidatorit të shoqërisë. Dy të tretat e anëtarëve të njësisë së ankandit caktohen me autorizim të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mbi bazën e kërkesës së likuidatorit të shoqërisë, 10 ditë përpara datës së shpalljes së ankandit.

7. Bazuar në kreun III, pika 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, në ankandet për shitjen e pasurive të këtyre shoqërive nuk zbatohet, për ish-pronarët, e drejta e parablerjes. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur dhe e kthyer me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

8. Gjatë zhvillimit të ankandit mbahet procesverbal, ku evidentohen emrat e anëtarëve të njësisë së ankandit, emrat e konkurruesve në ankand dhe emri i personit të shpallur fitues. Fituesi lidh kontratë për blerjen e objektit, pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, përfshirë dhe TVSH-në (20%) për asetet, që janë objekt i saj. Pagesa në asnjë rast nuk mund të bëhet me letra me vlerë ose bono privatizimi. Me lidhjen e kontratës, likuidatori bën dorëzimin e objektit, nëpërmjet aktit të dorëzimit.

9. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nuk paguan brenda 30 ditëve nga data e shpalljes fitues, vlerën e çmimit të arritur në ankand, ai e humbet të drejtën e blerjes, i konfiskohet sigurimi i ofertës, si dhe humbet të drejtën për të marrë pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

10. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e objekteve, të truallit dhe makinerive e pajisjeve është vlera e përcaktuar nga ekspertët vlerësues, të emëruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë, në përputhje me çmimet e tregut. Kësaj vlere i shtohet vlera sipas kontabilitetit e inventarit ekonomik, si dhe vlera e mjeteve të xhiros të objektit përkatës.

11. Para publikimit të objektit për shitje, shoqëria kërkon, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, hartën treguese përkatëse.

12. Likuidatori ngre një komision për vlerësimin e mjeteve të xhiros si më poshtë vijon:

a) Artikujt e grupit “a”, që kanë vlerë tregtimi në qarkullim normal, vlerësohen me çmimin e shitjes me shumicë në treg.

b) Artikujt, që kanë vlerë tregtimi, por me qarkullim të ngadalshëm, vlerësohen me vlerën kontabël të mbetur.

c) Artikujt e grupit “c”, që nuk gjejnë treg shitjeje, vlerësohen me vlerën kontabël të mbetur, shumëzuar me koeficientin 0.1.

ç) Për metalet me ngjyrë, si bakri, alumini, plumbi, zinku, kallaji, nikeli, ari dhe argjendi, vlera fillestare e ankandit, për rastet kur çmimi në treg është më i lartë se vlera kontabël e tyre në bilanc, llogaritet referuar çmimit përkatës sipas Bursës së Londrës (LME).

13. Raportet e vlerësimit të ekspertëve vlerësues, si dhe raportet e komisionit miratohen para publikimit, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

14. Në rast se nuk realizohet shitja me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, mbas shpalljes dy herë për shitje, objekti publikohet për herë të tretë, me një ulje VAM-i me 30 për qind të vlerës fillestare, duke i shtuar kësaj vlere edhe vlerën e truallit, të përcaktuar nga ekspertët vlerësues. Nëse edhe me këtë vlerë nuk shitet, atëherë për përcaktimin e destinacionit të mëtejshëm të objektit vendos Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

15. Bazuar në kreun III, pika 16 dhe 17 “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, makineritë dhe pajisjet që nuk kanë mundur të shiten me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, publikohen për herë të dytë me 50 për qind të vlerës së përcaktuar në fillim. Në rast se shitja nuk realizohet, zbatohen procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Të ardhurat e realizuara nga likuidimi, si shitja e asetëve, arkëtimi i debitorëve, të ardhurat nga qiraja apo dhe fitime të tjera, shërbejnë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërisë në likuidim, në mënyrë proporcionale në varësi të mjeteve monetare të siguruara. Përfshihen nga ky rregull detyrimet fiskale dhe ato sociale (paga dhe sigurime shoqërore), të cilat do të shlyhen tërësisht, sipas detyrimeve të pasqyruara në bilancin kontabël të miratuar nga organet kompetente. Për kërkesat debitorë, të paarkëtueshme, si në rastin, kur debitorët nuk ekzistojnë, kur kërkesat nuk janë të dokumentuara apo është humbur procesi gjyqësor etj., procedohet duke i kaluar si shpenzime likuidimi.

17. Likuidatori nuk mund të lidhë kontratë dhe as nuk mund të shesë asete me mirëkuptim, pa autorizimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

18. Në publikimin për shitje të pasurisë së shoqërisë në likuidim përfshihen edhe objektet e dhëna me qira, përpara datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

19. Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e parashikuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2008 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

20. Anulohen të gjitha miratimet e privatizimit të asetëve të përfshira në kapitalin e shoqërisë që nuk kanë filluar procedurën e përgatitjes së dokumentacionit para datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim me vendim gjyqi.

21. Udhëzimi nr.317, datë 8.4.2009 “Për shoqëritë anonime në likuidim e sipër, me kapital shtetëror” i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.7203, datë 16.9.2009

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.6291, DATË 17.8.2005 “PËR EVIDENTIMIN, ADMINISTRIMIN DHE RUAJTJEN E AKTEVE E TË DOKUMENTEVE NOTERIALE, SI DHE PËR ORGANIZIMIN DHE RUAJTJEN E ARKIVAVE NOTERIALE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë“, i ndryshuar, dhe të nenit 71 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë“, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në fjalinë e parë të pikës 2 pas fjalëve “repertori e koleksioni” shtohen fjalët “dhe në rastet kur dokumenti nuk është redaktuar prej tij, duke i dhënë atij vetëm një numër repertori.”

2. Fjalja e parë e pikës 3 ndryshohet si vijon:

“dokumenti i vërtetimit të nënshkrimeve, përfshirë edhe nënshkrimin e përkthyesit, redaktohet në mënyrë të veçantë, në numër të njëjtë njësisë sa janë njësitë e dokumentit me nënshkrime të vërtetuara nga noteri, plus një njësi që do të mbahet në arkivën e noterit.”

3. Në pikën 4 bëhen ndryshimet si vijon:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre.”

b) Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

“Në rastet e vërtetimit të nënshkrimeve, sipas nenit 55 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë“, i ndryshuar, përveç dokumentit të vërtetimit të nënshkrimit, noteri ruan në arkivë edhe një kopje të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar dhe një kopje të dokumentit të identifikimit (kur është rasti i identifikimit me dokument).”

4. Në pikën 6 fjalët “si dhe përmbajtja e tekstit të nxjerrë nga përmbajtja e origjinës”, zëvendësohen me fjalët “si dhe ekstrakti i dokumentit origjinal”.

5. Paragrafi i parë i pikës 7 ndryshohet si vijon:

“Në rastin e vërtetimit të kopjes me dokumentin origjinal në arkivin e noterit, ruhet një kopje e tij. Noteri bën shënimin “Vërtetohet se njësia është kopje e njëjtë me dokumentin origjinal. Vërtetimi i kopjes me origjinalin mund të bëhet me dokumentin e veçantë apo në të njëjtin akt me kopjen që vërtetohet.”.

6. Në pikat 11,12 dhe 16 fjala “indekse” zëvendësohet me fjalën “indeks”.

7. Në paragrafin e dytë të pikës 11 shtohet fjalja me përmbajtje si vijon:

“Shënimi në indeksin përkatës bëhet vetëm për aktet dhe veprimet noteriale të cilat përmbajnë numër repertori dhe koleksioni”.

8. Në paragrafin e katërt të pikës 12, fjala “sekuestruan” zëvendësohet me fjalën “sekretuan”.

9. Paragrafi i parafundit i pikës 14 ndryshohet si vijon:

“Kur çelet ose revokohet testamenti bëhet shënim në kolonën përkatëse të regjistrir dhe nënshkruhet nga noteri, i cili vendos dhe numrin përkatës të veprimit noterial që bën çeljen ose revokimin e tij.”

10. Paragrafi i parafundit i pikës 15 ndryshohet si vijon:

“Kur sendet e depozituara i dorëzohen depozituesit, bëhet shënim në kolonën përkatëse të regjistrit dhe nënshkruhet nga noteri, i cili vendos dhe numrin përkatës të procesverbalit të dorëzimit.”

12. Në pikën 17 bëhen ndryshimet si vijon:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Kur në regjistër nuk mund të regjistrohen më veprime, për shkak se ai është mbushur, noteri bën shënimin e mbylljes së regjistrit, duke shënuar datën, muajin, vitin, numrin e fletëve e faqeve të regjistrit, numrin e fundit të repertorit dhe koleksionit së bashku me nënshkrimin dhe vulën e njomë. Regjistri i mbushur vendoset në arkivë dhe mbahet në ruajtje të përhershme.”

b) Në paragrafin e tretë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në këtë rast, noteri pasi bën shënimin e nxjerrjes nga përdorimi të regjistrit, njofton brenda 3 ditëve nga dita e bërjes së shënimit, strukturën përgjegjëse për aktivitetin e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë.”

13. Në paragrafin e parë të pikës 23, fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

“Kur nuk ka një zyrë tjetër në atë bashki, arkivi i dorëzohet një noteri të një zyre të ndodhur në bashkinë më të afërt, i cili përcaktohet në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e arkivit.”

14. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen noterët dhe strukturat përgjegjëse për aktivitetin e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Enkelejd Alibeaj

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.2345, datë 7.9.2009, vendosi pranimin e kërkesës së shtetasës Burbuqe Gjyli për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Namik Danglli e caktimin e saj si kujdestare.

KËRKUESJA
Burbuqe Gjyli

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.980, datë 13.7.2009, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Klement Metushi, i datëlindjes 6.12.1975 dhe caktimin e shtetasit Adi Metushi si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUESJA
Mynevere Metushi

KËRKESË

Shtetasja Selime Tabaku, banuese në fshatin Velogosht (Kuçovë), kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj shtetasit Sali Tabaku.

KËRKUESE
Selime Tabaku

KËRKESË

Shtetasi Nevruz (Hafuz) Gezdari, banues në komunën Petrelë (Tiranë), kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të saj shtetasit Xhevair Gezdari.

KËRKUESI
Nevruz (Hafuz) Gezdari

KËRKESË

Shtetasi Xhavid Maci, banues në Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Bajram Maci.

KËRKUESI
Xhavid Maci

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 6.10.2009
 Doli nga shtypi më 8.10.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë